

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6536
E martë, 15 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Bien rastet me të infektuar me Covid

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)
KRITIKON GJYKATËN SPECIALE | FAQE 4-5

KMDLNJ-ja: SPECIALJA PO SHKEL TË DREJTAT E ISH-UDHËHEQËSVE TË UÇK-së



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka konfirmuar pretendimet e avokatëve për shkelje të të drejtave të ish-krerëve të UÇK-së të cilët po mbahen në Hagë. Sipas KMDLNJ-së, tani është e pamundur të monitorohen nga afër apo drejtpërdrejt të drejtat e ish-udhëheqësve të UÇK-së që po mbahen në paraburgim. KMDLNJ ka vlerësuar se shkelje tjetër e rëndë nga kjo gjykatë është edhe fshehja e provave shfajësuese për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin

AKTUALE



RUSIA "SHEH" MUNDËSI PËR MARRËVESHJE ME PERËNDIMIN F. 2

LISTA "GUXO" REGJISTROHET PARTI POLITIKE F. 7

KOSOVA, E GATSHME TA RRIË BASHKËPUNIMIN ME BRITANINË F. 3



EKONOMI



MBI 375 MILIONË KUPONË FISKALË U LËSHUAN GJATË VITIT 2021 NË KOSOVË F. 8

ZRRE-ja: HYRJA E ZYRTARËVE TË PSD-SË NË ZYRË, METODË E DHUNSHME F. 8

SPORT



LIGA E KAMPIONËVE RIKTHEHET ME SUPERPËRBALLJEN PSG - REAL F. 10

SBASHK-u kundërshton draftin e Ligjit të Pagave, paralajmëron protesta dhe greva | FAQE 7



ASHAK-u: POLITIKAT DESTABILIZUESE TË SERBISË JANË BËRË MË AGRESIVE | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@ml.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia "sheh" mundësi për marrëveshje me Perëndimin

MOSKË, 14 SHKURT - Ministri i Punëve të Jashtme i Rusisë, Sergei Lavrov, i ka sugjeruar të hënën presidentit rus Vladimir Putin që Moskë ta vazhdojë rrugën diplomatike në përpjekjet për të siguruar garanci të sigurisë nga Perëndimi, ndërkohë që rriten tensionet rreth Ukrainës.

Lavrov i ka thënë Putinut se Shtetet e Bashkuara kanë bërë propozime konkrete për zvogëlim të rreziqeve ushtarake, mirëpo ka thënë se nuk kanë qenë të kënaqshme përgjigjet nga Bashkimi Evropian dhe aleanca ushtarake e NATO-s. Në një komunikim televiziv, Putini është parë duke i kërkuar Lavrovit nëse ka mundësi të arrijtes së marrëveshjes për t'i adresuar shqetësimet ruse për siguri, apo nëse palët janë vetëm duke hyrë në negociata të vështira.

Lavrov ka thënë se pala ruse tashmë ka paralajmëruar më shumë se një herë "që nuk do të lejohet negociata pa fund për pyetjet që kërkojnë zgjidhje sot". "Mirëpo si ministër i Jashtëm duhet të them se ka gjithmonë mundësi".

Këto komente janë parë si shenjë për ulje të mundësisë së pushtimit rus, pas paralajmërimeve të vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara se Rusia mund ta sulmojë Ukrainën në çdo kohë. Moskë, e cila ka mbledhur më shumë se 100 000 trupa afër kufirit të Rusisë me Ukrainën, ka mohuar planet për pushtim dhe ka akuzuar ShBA-në dhe aleatët e saj për histeri.

Lavrov i ka thënë se ka pranuar përgjigje "jo të kënaqshme" pas një letre që u ka dërguar dhjetëra anëtarëve të BE-së dhe NATO-s sa i përket "sigurisë së

pandashme" - referencë ndaj ankesës së Rusisë se Ukraina dhe shtetet e Perëndimit janë duke rritur sigurinë në kurriz të Rusisë dhe se kjo përbën shkelje të marrëveshjeve ndërkombëtare. "Kam pranuar përgjigje jo të kënaqshme, asnjëri prej kolegëve ministra nuk i është përgjigjur drejtpërdrejt mesazhit", ka thënë ai.

"Prandaj ne do të kërkojmë reagim konkret nga secili shtet". Në kërkesat e Moskës ndaj Perëndimit përfshihen edhe ato që: Ukraina të mos pranohet në NATO; NATO-ja t'i japë fund aktivitetit ushtarak në Evropën Lindore dhe t'i tërheqë trupat nga Polonia dhe republikat baltike, Estonia, Letonia dhe Lituania; si dhe Aleanca veriatlantike të mos pozicionojë raketa në shtetet afër apo në kufi me Rusinë.



Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja janë përgjigjur duke thënë se Ukraina ka të drejtë të zgjedhë aleatët e vet, mirëpo i kanë ofruar Rusisë mundësinë e negociimit rreth raketave dhe çështjeve të tjera. Nëse Rusia pushton Ukrainën,

kjo nuk do të ishte hera e parë. Rusia ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014. Ky vend, po ashtu, mbështet rebelët në konfliktet në rajonet lindore të Ukrainës, në të cilat kanë vdekur rreth 14 000 persona.

Pjesëtarët e grupit Lev Tahor gjenden në Kumanovë

KUMANOVË, 14 SHKURT - Një grup i pjesëtarëve të sektit fetar hebre, Lev Tahor, po qëndron në qytetin e Kumanovës në Maqedoninë e Veriut nga data 5 shkurt. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, bëhet fjalë për 30 persona të cilët në Maqedoninë e Veriut kanë hyrë përmes Aeroportit të Shkupit. Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar se "bëhet fjalë për një grup fetar hebre që është vazhdimisht në lëvizje pasi është detyruar të largohet nga shumë vende si Izraeli, Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe Meksika".

Sipas policisë, grupi përfshin shtetas amerikanë, kanadezë, belgë dhe amerikano-jugorë. Detaje mbi arsyet e largimit të

tyre nga këto vende nuk janë bërë me dije. "Njoftojmë opinionin se personat e vërejtur në Kumanovë janë një grup i pjesëtarëve të bashkësisë fetare hebre. Këta persona i respektojnë ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ata janë këtu në përputhje me dispozitat ligjore dhe kanë leje për qëndrim të përkohshëm në Maqedoninë e Veriut", është thënë në njoftimin e Policisë.

Sipas ligjit maqedonas, personat që kanë lejeqëndrim të përkohshëm mund të qëndrojnë 90 ditë në këtë shtet.

Sipas disa xhirimeve të publikuara në rrjete sociale, duket se ata janë strehuar në një shtëpi private, në pjesën



maqedonase të Kumanovës. Njoftimi i Policisë është bërë pasi në rrjetet sociale ka pasur reagime të shumta nga qytetarët mbi veshjen dhe

lëvizjet në grup të këtyre personave. "Grupi nuk paraqet ndonjë rrezik dhe apelojmë për tolerancë dhe solidaritet me të. Sipas të dhënave që kemi, grupi

është në lëvizje të vazhdueshme dhe pritet të largohet nga vendi ynë në ditët në vijim", ka bërë me dije policia në Kumanovë.

Suedia rekomandon dozën e katërt të vaksinës për të moshuarit

STOKHOLM, 14 SHKURT - Agjencia Shëndetësore e Suedisë ka rekomanduar që qytetarët 80 vjeç e më të vjetër ta marrin dozën e katërt të vaksinës kundër koronavirusit, me qëllim që të mos bie efektiviteti i vaksinave.

Në rekomandimin e bërë të hënën nga kjo agjenci thuhet se doza e katërt rekomandohet për të gjithë personat që jetojnë në shtëpi të kujdesit apo ata që marrin shërbime asistence në shtëpi.

Doza e katërt, sipas rekomandimit, duhet të administrohet të paktën katër muaj pas dozës përforcuese, ka njoftuar Agjencia Shëndetësore. Suedia më herët gjatë këtij viti shënoi shifra rekorde të infektiveve, teksa varianti Omicron i koronavirusit është përhapur me shpejtësi në mbarë shtetin.

Por, autoritetet suedeze kanë hequr kufizimet, duke argumentuar se simptomat më të buta nga varianti Omicron

dhe fushata e imunizimit me doza përforcuese, kanë ulur presionin ndaj sistemit të kujdesit shëndetësor. "Doza përforcuese rrit mbrojtjen. Prandaj, ne besojmë se personat 80 vjeç e më të vjetër do të përfitojnë nga një dozë e dytë përforcuese", ka thënë epidemiologu Anders Tegnell. Agjencia Shëndetësore Suedeze ka njoftuar se dozat përforcuese duhet të jenë të kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "Moderna".



AShAK-u: Politikat destabilizuese të Serbisë janë bërë më agresive

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 SHKURT - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka theksuar se politikat destabilizuese të Serbisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor së fundmi janë përshkallëzuar dhe “janë bërë më agresive”. “Ngecjet në reforma dhe në demokratizim, krizat e njëpasnjëshme politike, korrupsioni dhe krimi i organizuar, në të cilat janë përfshirë shoqëritë ballkanike, kanë krijuar ambient të përshtatshëm për depërtim të papenguar të ndikimeve politike të financuara nga fuqitë me ndikim në rajon, siç janë Rusia dhe Kina”, është thënë në deklaratën e Akademisë së Shkencave të lëshuar të hënën. AShAK-u ka thënë se situata e tanishme në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, do të duhej të nxiste Perëndimin që të formulonte

një strategji “më të qartë kundrejt Serbisë ndaj synimeve të saj destabilizuese dhe të aleancave të saj me Rusinë dhe Kinën”.

AShAK ka theksuar se Serbia ka arritur t’i instrumentalizojë komunitetet serbe në Bosnjë, Mal të Zi dhe Kosovë. “Në Kosovë Serbia është katalizatore e të gjitha krizave politike, madje kuadri politik i brendshëm dhe i jashtëm, që aktualisht dikton profilizimet e spektrit politik të vendit”, ka vlerësuar AShAK.

Sa i përket dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, AShAK-u ka theksuar se ky proces nuk ishte i frytshëm, për shkak të, siç ka thënë, Serbia nuk pranon të bëjë asnjë koncesion për Kosovën, duke “mos pranuar të shkojë një hap më tej se Rezoluta 1244 e OKB-së”, ka vlerësuar AShAK-u. “Akademia e Shkencave dhe e Arteve e

Kosovës mbështet fuqishme përfshirjen e ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi, veçanërisht qëndrimin e shprehur së fundi nga i dërguari i posaçëm Gabriel Escobar, i cili rikonfirmoi se ShBA-ja i jep mbështetje të palëkundur sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës”, thuhet në këtë deklaratë.

Së fundmi, BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara i kanë shtuar thirrjet ndaj Kosovës dhe Serbisë, që t’i rikthehen dialogut, pasi palët nuk kanë zhvilluar një takim të nivelit të lartë që prej korrikut të vitit të kaluar.

AShAK-u ka denoncuar “trysninë e Bashkimit Evropian” mbi Kosovën sa i përket themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Kjo është një qasje joadekuate e strukturave të BE-së, meqë është e ditur se një asociacion i tillë do ta bënte Kosovën shtet jofunksional dhe do të krijonte ‘hapësirë kushtetuese’ për autonomi

territoriale të komunave serbe në Kosovë, përfshirë edhe ndarjen e saj”, ka theksuar AShAK teksa kujtoi se Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte vlerësuar se disa pika të marrëveshjes për asociacionin nuk ishin në përputhje me aktin më të lartë juridik të shtetit.

AShAK-u, po ashtu, përmendi edhe trysninë e Rusisë ndaj Brukselit sa i përket dialogut dhe rikujtoi edhe një paralele që ministri i Punëve të Jashtme i Rusisë, Sergei Lavrov, ka bërë me marrëveshjen e asociacionit dhe atë të Minskut, për dy rajonet në lindje të Ukrainës, ku Kievi po lufton me separatistët e mbështetur nga Rusia.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, po ashtu, ka kritikuar nismën rajonale “Ballkani i hapur”, pasi ka thënë se Serbia po përdor nisma të tilla për ta destabilizuar rajonin dhe për t’i goditur BE-në dhe NATO-n. Për “Ballkanin e Hapur” akademia tha se minon “Procesin

e Berlinit”, sepse “bën izolimin politik të Kosovës dhe se do të ketë pasoja largvajtëse për raportet e ardhshme mes shteteve të Ballkanit Perëndimor”. Po ashtu, akademia ka denoncuar retorikën në Shqipëri dhe Kosovë për bashkimin kombëtar, pasi ka thënë se deklaratatë të tilla i shkojnë në favor politikës serbe. “Retorika nacionaliste e kreut politik të Shqipërisë për bashkim kombëtar, për heqje kufiri me Kosovën etj., që gjoja përfshihen në projektin ‘Ballkani i hapur’, njësoj si diskutimi politikisht diletant në Kosovë për bashkim kombëtar, i shkojnë në favor politikës së Serbisë, duke e konsideruar ‘Serbinë e madhe’ si pasojë logjike dhe kundërpeshë politike kundrejt ‘Shqipërisë së madhe’ dhe duke vendosur shenjën e barazimit mes Kosovës dhe Republika Sërpaska, pavarësisht se bëhet fjalë për dy realitete krejtësisht të ndara politike dhe historike”.



Haxhiu pret ambasadorin amerikan, bisedojnë për sundimin e ligjit

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministri i Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Ministri Haxhiu, duke i uruar mirëseardhje, e informoi ambasadorin Hovenier për

prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë dhe përparimin e shënuar deri më tani dhe objektivat në këtë drejtim. Ambasadori Hovenier e njoftoi ministren Haxhiu për angazhimin e tyre në çështje të rëndësishme me fokus për sundimin e ligjit dhe qeverisja e

mirë. Të dyja palët e përgëzuan njëra-tjetrën për bashkëpunimin e ndërsjellë deri tani dhe ritheksuan gatishmërinë për të thelluar edhe më tutje këtë bashkëpunim në drejtim të forcimit të rendit kushtetues e ligjor në Republikën e Kosovës.





KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ) KRITIKON GJYKATËN SPECIALE

KMDLNj: Specialja po shkel të drejtat e ish-udhëheqësve të UÇK-së

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka konfirmuar pretendimet e avokatëve për shkelje të të drejtave të ish-krerëve të UÇK-së të cilët po mbahen në Hagë. Sipas KMDLNj-së, tani është e pamundur të monitorohen nga afër apo drejtpërdrejt të drejtat e ish-udhëheqësve të UÇK-së që po mbahen në paraburgim. KMDLNj ka vlerësuar se shkelje tjetër e rëndë nga kjo gjykatë është edhe fshehja e provave shfajësuese për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOÇI

PRISHTINË 14 SHKURT - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kritikuar Gjykatën Speciale për procesin ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Përmes një reagimi për medie, këshilli ka vlerësuar se ZPS-ja po shkel të drejtat e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Sipas KMDLNj-së, për shkak të rrethanave objektive dhe subjektive është e pamundur të monitorohen nga afër apo drejtpërdrejt të drejtat e ish-udhëheqësve të UÇK-së që po mbahen në paraburgim në Hagë. "Aktualisht janë tetë

shtetas të Kosovës që mbahen në Njësine të Paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë. Për shkak të rrethanave objektive dhe subjektive është e pamundur të monitorohen nga afër apo drejtpërdrejt të drejtat e tyre nëse respektohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e personave të privuar nga liria dhe monitorimi bëhet nga distanca. Vetëm nga data 15 korrik 2021, me ndërprerje shkak i masave anti-Covid janë lejuar, fillimisht vizitat familjare të ngushtë, kurse nga shtatori 2021 edhe të tjerëve, kurse aktualisht lejohen vetëm vizitat familjare. Monitorimi i seancave

gjyqësore bëhet 100 për qind nga distanca", ka vlerësuar KMDLNj, duke theksuar se problemi kryesor i monitoruesve të KMDLNj-së është mbyllja e seancave dhe tekstet e redaktuara deri në masën 75 për qind. "Ndërsa ekskluzivitete për vizita monitoruese kanë Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Avokati i Popullit nga Holanda dhe këtu përfundon monitorimi, ndonëse themeluesi DHS është Kuvendi i Kosovës dhe deklarativisht është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës. Problemi kryesor i monitoruesve të KMDLNj-së është mbyllja e seancave sikur edhe tekstet e

redaktuara deri në masën 75 për qind. Kjo praktikë duhet të ndryshojë sepse në emër të mbrojtjes së dëshmitarëve po kompromitohet integriteti i procesit gjyqësor, përgatitja e mbrojtjes si dhe transparenca përmes një monitorimi efektiv", është thënë në reagim, duke shtuar se të gjitha kërkesat për zëvendësim të masës së arrestit me një masë më të butë përkundër garancive të shteteve të treta janë refuzuar, ndërkaj garancitë e ofruara nga Policia e Kosovës janë përbuzur skajshmërisht duke mos e pranuar profesionalizmin dhe kapacitetin e Policisë së Kosovës për ta administruar arrestin shtëpiak. "Prokurori i ZPS-së ka fshehur provat shfajësuese për ish-krerët e UÇK-së në deklaratat e ish-ambasadorit të OSBE-së, Daan Everts, Bujar Bukoshit dhe Departamentit të Shtetit, duke vënë mbrojtësit dhe mbrojtjen në pozita të pabarabarta me Prokurorinë. Zgjatja e

paraburgimit përtej masave të arsyeshme ndikon në procesin gjyqësor duke e komprometuar atë nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe këtë tendencë e forcon edhe kërkesa e Prokurorisë se i duhen 1 863 orë punë për pyetjet e bëra prej palës thirrëse që shumëfish e zgjatë kohën e hetimeve krahasuar me të gjitha tribunale të ndërkombëtare. Realisht, po të pranohej ky propozim i Prokurorisë, edhe në rast se dosja Thaçi dhe e të tjerëve t'i dorëzohen Gjykatës në vitin 2023, në rastin më të mirë, Prokurorisë së Specializuar, nëse punon me këtë dinamikë, do t'i duheshin 9 deri në 11 vjet për të përfunduar hetimet dhe prezantimin e pyetjeve", ka vlerësuar KMDLNj. Sipas KMDLNj-së, prokuroria e ZPS-së, ndonëse ka premtuar se dosjen paraprake do ta dorëzojë në dhjetor të vitit 2021, ende nuk e ka bërë këtë dhe materialet dorëzohen pak ditë para seancave për ecurinë

Kosova, e gatshme ta rrisë bashkëpunimin me Britaninë

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim të dërguarin e kryeministrit britanik për tregtinë për Ballkanin Perëndimor, deputetin Martin Vickers. Në takim është diskutuar për marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve, të cilat u vlerësuan të shkëlqyeshme me mundësinë e thellimit të mëtejme të tyre. Osmani ka vlerësuar ndihmën e Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën, duke shfaqur shpresë për shtimin e saj. Në këtë kontekst, ajo ka shfaqur gatishmërinë për rritjen e bashkëpunimit në sferën e ekonomisë dhe mbrojtjes. Sipas Osmanit, është mirë që lidhjet historike ndërmjet dy shteteve të zberthehen në mundësi ekonomike. Më tej, Osmani i ka bërë me dije deputetit Vickers se institucionet e Kosovës kanë bërë përparim për sundimin e ligjit dhe krijimin e mjedisit të përshtatshëm për investitorët e huaj. Deputetin e parlamentit britanik

e ka pritur edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. Në takim, ndër të tjera, u bisedua për zhvillimet politike, bashkëpunimin ndërparlamentar, atë ekonomik dhe tregtar ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Konjufca ka falënderuar Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë Kosovës në të gjitha etapat e shtetndërtimit, si dhe në rrugën e zhvillimit dhe të forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar. "Mbretëria e Bashkuar ka pasur dhe vazhdon të ketë rol të veçantë në çlirim, pavarësinë, rindërtimin dhe rimëkëmbjen e Kosovës. Bashkë me miqtë, shteti ynë ka shënuar arritje të mëdha dhe në partneritet me ta do të ecë drejt objektivave të së ardhmes", ka thënë Konjufca, duke kërkuar përkrahjen e mëtejme për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Deputeti Vickers e falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen dhe konfirmoi vazhdimin e mbështetjes së Mbretërisë së



Bashkuar për Kosovën si dhe përkushtimin për shtimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona. Deputeti i parlamentit britanik është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti. Sipas njoftimit të Zyrës së Kryeministrit, deputeti britanik ka vlerësuar veprimet e Qeverisë së Kosovës për luftimin e korrupsionit. "Edhe

pse nuk jemi më pjesë e Bashkimit Evropian, të jeni të sigurt se ne do të vazhdojmë t'u qëndrojmë afër dhe të ndihmojmë", ka deklaruar Vickers.

Duke theksuar se Mbretëria e Bashkuar është partner i domosdoshëm i Kosovës, kryeministri Kurti ka falënderuar emisarin për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë nga

Mbretëria e Bashkuar para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, si dhe para dhe pas shpalljes së pavarësisë. Lidhur me mundësitë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet të dyja vendeve, kryeministri Kurti ka veçuar potencialin e mërgatës së madhe që ka Kosova në Mbretërinë e Bashkuar dhe që ata mund të jenë si urë lidhëse.

e gjendjes. "Nga aspekti i të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, KMDLNJ, duke mos e paragjykuar prezumimin e pafajësisë në asnjë mënyrë konstaton se ndaj të arrestuarve, shtetas të Kosovës që janë në Njësinë e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, në mënyrën më flagrante shkelet parimi i prezumimit të pafajësisë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, kryetarja e Dhomave të Specializuara, një pjesë e institucioneve kosovare dhe një pjesë e medieve e që e vënë në pikëpyetje të madhe të drejtën ligjore dhe njerëzore për organizim të një procesi gjyqësor të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht apo të ndonjë interesi tjetër", ka vlerësuar KMDLNJ, duke shtuar se ka bërë kërkesë dy herë për vizitë monitoruese Njësisë së Paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, por i është refuzuar kërkesa me

arsyetimin e kufizimeve shkak të rritjes së rasteve të të prekurve nga Covid.

Avokatët e vlerësojnë skandaloze fshehjen e provave shfajësuese

Në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes ndaj ish-krerëve të UÇK-së, mbrojtja e ish-udhëheqësve të UÇK-së ka akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se ka fshehur provat shfajësuese për klientët e tyre.

Gregory Keohe, avokat i Hashim Thaçit, ka thënë se ZPS-ja për katër vjet ka mbajtur fshehur deklaratën e ish-ambasadorit të OSBE-së në Kosovë, Dan Everts, e cila është shfajësuese për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Ai ka bërë me dije se kjo deklaratë, e cila iu ka dorëzuar mbrojtjes të hënën, hedh

dyshime të mëdha mbi provat dhe aktakuzën e ZPS-së. "I nderuar gjykatës, a nuk do të doni të dini se çfarë ai (ambasadori Everts), për klientin tim, z. Thaçi, që ka ndërvepruar me ambasadorin Everts gjatë gjithë kësaj periudhe kohore? A nuk do të doni ju të mësoni këtu kur e keni shqyrtuar kërkesën për lirim të parakohshëm? Lëreni me një anë dyshimin e arsyeshem, fajin apo pafajësinë. Pra, unë nuk shikoj ndonjë arsye ose motiv se pse Thaçi donte që UÇK-ja donte të kryente krime etnike, sepse kjo do ta dëmtonte reputacionin e tij ndërkombëtar. Për mendimin tim, nuk kishte lidhje midis krimeve dhe udhëheqjes qendrore të shqiptarëve të Kosovës. Derisa ne po diskutojmë provat, asgjë nga këto nuk ju është dhënë juve, i nderuar gjykatës!", ka thënë avokati Keohe. Sipas tij, ambasadori Everts ka

theksuar se UÇK-ja nuk kishte asnjë mundësi që ta nxiste dhunën në terren. "Jo që do të duhej të bëhej i njohur ky dokument, por këtë burra do të duhej të lirohen. Këta burra duhet të lirohen edhe në bazë të dokumentit (ambasadorit Everts) të cilën këta (prokuroria) e lanë aty. Prokurori duhet të përpiqet ta gjejë të vërtetën. Ju (gjykatës) nuk e keni pasur kurrë këtë dokument. As ne nuk e kemi pasur", ka thënë ai, duke shtuar se nuk është i vetmi dokument që nuk e ka dorëzuar prokuroria. "Ata nuk kanë dorëzuar edhe një dokument nga Departamenti Amerikan i Shtetit, i datës 4 maj 1999", ka thënë Keohe.

Avokati i ka bërë thirrje gjykatës që t'i lirojë krerët e UÇK-së. "Kjo gjykatë duhet t'i lirojë këta zotëri, me çfarëdo lloj kushti që mund të vendosë gjykata, sepse një zyrtar i lartë i bashkësisë ndërkombëtare ka hedhur

dyshime mbi gjithçka që ka përfshirë në këtë aktakuzë që ka bërë ZPS-ja. Nuk mund të mbahen njerëzit në burg në bazë të kësaj", ka thënë ai.

Kurse avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka kërkuar të dijë nga prokuroria se edhe sa materiale shfajësuese ka. "Duam të dimë shumë qartë nga prokuroria se sa materiale të tjera shfajësuese ka ende në zotërim. Është shumë me rëndësi që ne këtë ta dimë, sepse ka të bëjë edhe me pikën tjetër të rendit të ditës që janë hetimet e mbrojtjes. Ne nuk e dimë se këso materiale të tjera do të marrin, sidomos kur bëhet fjalë për materialet shfajësues, të cilat janë jetike për planifikimin e hetimeve të mbrojtjes. Nuk mund të largohemi nga kjo konferencë pa e marrë këtë informacion nga prokuroria", ka thënë Emmerson.

Për 14-vjetorin e pavarësisë Kuvendi mban seancë solemne

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER)- Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës. Kryesia ka vendosur që me rastin e 14-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, të enjten, më 17 shkurt, në orën 11:00, Kuvendi të mbajë seancë solemne. Seanca e rregullt plenare do të mbahet të martën, më 22 shkurt, në orën 10:00. Në këtë seancë, pas deklarimeve jashtë

rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi pritet ta shqyrtojë Projektligjin nr. 08/L-106 për ratifikimin e marrëveshjes për ndihmë të ndërsjellë juridike në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Projektligjin nr. 08/L-118 për ratifikimin e Marrëveshjes për Statusin e Forcave në mes të

Republikës së Kosovës dhe Shtetit të Kuvajtit, si dhe Projektligjin nr. 08/L-119 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi në kontekstin e Aderimit në Bashkimin Evropian. Në rend të ditës së kësaj seance do të jetë edhe shqyrtimi i parë i projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.



Gjermania përkrah Asociacionin e Komunave të Kosovës

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, së bashku me udhëheqësen e bashkëpunimit për zhvillim në Ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, Vera Baumann dhe udhëheqësin e GIZ-it në Kosovë, David Oberhuber, vizituan Asociacionin e Komunave të Kosovës. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Imri Ahmeti, ka falënderuar

ambasadën dhe shtetin e Gjermanisë për përkrahjen që kanë dhënë për komunat dhe për Asociacionin e Komunave të Kosovës për vite me radhë. Po ashtu, Ahmeti ka njoftuar mysafirët me punën dhe angazhimin e Asociacionit të Komunave në lobim dhe shërbime ndaj komunave si dhe për bashkëpunimin e nivelit lokal me nivelin qendror. Ambasadori i Gjermanisë në

Kosovë, Joern Rohde, ka falënderuar delegacionin e AKK-së për pritjen dhe për bashkëpunimin që është zhvilluar për vite me radhë, sidomos mes AKK-së dhe GIZ-it në projekte dhe programe të ndryshme për qeverisjen lokale në Kosovë. Në këtë takim është biseduar edhe për mundësitë për bashkëpunime të reja në mes të komunave gjermane dhe komunave të Kosovës dhe vetë AKK-së.



Aktakuzë për falsifikim të parasë

PRIZREN, 14 SHKURT (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit A. K. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale "Falsifikimi i parasë" nga neni 296, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Sipas aktakuzës, më 23.09.2021, rreth orës 12:55 në rrugën "Enver Hadri" në Prizren, me dashje, duke e ditur se paraja është e falsifikuar, ka të njëjtën me qëllim që më pas ta vë në qarkullim si të vërtetë, në atë



mënyrë që hyn në një lokal pronar i të cilit është H. M. nga Prizreni, merr një pako të cigareve "Marlboro" dhe bën

pagesën me kartëmonedhën në shumën prej 100 eurosh dhe largohet nga vendi i ngjarjes duke e marrë kusurin me vete. "Po ashtu, më 18.09.2021, rreth orës 08:20, në Prizren, i pandehuri A. K., hyn në një market, pronar i të cilit është N. M., nga Prizreni, merr dy pako të cigareve dhe bën pagesën me kartëmonedhën në shumën prej 100 eurosh dhe largohet nga vendi i ngjarjes duke e marrë kusurin me vete. Në të dyja rastet është vërtetuar se kartëmonedhat janë falsifikim i plotë, përmes raportit të

ekspertimit të datës 17.11.2021 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë. Me këto veprime i pandehuri A. K. ka përbushur elementet e veprës penale "Falsifikimi i parasë", sipas KPRK-së. Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Prizren.

Mbi 60 për qind e studentëve të mjekësisë mësimin e marrin nëpër klinika të QKUK-së



PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka pritur të hënën në takim dekanen e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka-Kërliu dhe prodekanin prof. Fatos Sada, me të cilët kanë

biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë, sidomos për krijimin e hapësirës vepruese të Fakultetit të Mjekësisë për ngritjen e kapaciteteve akademike në sektorin e shëndetësisë.

Në këtë drejtim ministri Latifi ka shprehur falënderimin e tij për bashkëpunimin me Fakultetin e Mjekësisë, duke pasur në fokus integrimin e kapaciteteve klinike dhe akademike jo vetëm kur jemi

tek edukimi postdiplomik, por edhe duke e ditur faktin se mbi 60 për qind e studentëve të mjekësisë mësimin e marrin nëpër klinika të QKUK-së. Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë,


Manxhuka-Kërliu, ka shprehur gatishmërinë e plotë të saj dhe të institucionit që përfaqëson për ta përkrahur profesionalisht Ministrinë e Shëndetësisë në të gjitha sferat.

Hyseni: Kalaja e Pogragjës do të duhej të jetë pikë e rëndësishme për vizitorë dhe turistë

GJILAN, 14 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur sot në takim përfaqësues nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, Fakulteti i Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës, Qendra e Trashëgimisë Kulturore, zyrtarë komunalë e përfaqësues nga fshati

Pogragjë. Hyseni ka thënë se rajoni i Anamoravës është një nga vendet mjaft të pasura si me monumente, gjithashtu edhe me vlera të tjera të kulturës historike. "Kalaja e Pogragjës, si një nga luginat më të rëndësishme e pahulumtuar gjer në fund, do të duhej të

ishite pikë e rëndësishme për vizitorë dhe turistë. Diskutuam rreth investimeve në qasjen e saj, rrugën e shtegun për ecje, ndërtimin e kinemasë së hapur afër saj e shumë atraksione të tjera të cilat do ta shtonin atraktivitetin turistik të kalasë, e turizmin Gjilanit", ka thënë Hyseni.



SBASHK-u kundërshton draftin e Ligjit të Pagave, paralajmëron protesta dhe greva

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 SHKURT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) ka kundërshtuar draftin e propozuar të Ligjit të Pagave. Sipas SBASHK-ut, nëse nuk merren parasysh kërkesat e tyre, atëherë në pjesën e tyre të muajit mars do të ketë veprime sindikale. "Përfaqësuesit e të punësuarve në arsim, që nga çerdhjet e deri në universitete, pasi kanë bërë vërejtje konkrete, kanë shprehur kundërshtime të bazuara ndaj këtij versioni të

draftligjit të pagave. Për SBASHK-un është i papranueshëm raporti i koeficienteve 1 me 20, që favorizon shumë qeveritarët në dëm të të punësuarve në arsim, kulturë, por edhe në sektorë të tjerë, po ashtu është e papranueshme edhe tendenca për zbritje të koeficienteve për numrin më të madh të të punësuarve në arsim", është thënë në reagimin e SBASHK-ut. Po ashtu, sindikalistët paralajmërojnë veprime sindikale nëse nuk përfillen kërkesat e tyre. "Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të



universiteteve kanë marrë vendim unanim se nëse MASHTI dhe Ministria që drejton ministri Sveçla u ikin takimeve me

përfaqësuesit e SBASHK-ut, apo nuk përfillin kërkesat e argumentuara të punëtorëve të tërë sektorit të arsimit e të kulturës, atëherë në pjesën e parë të marsit do të ketë veprime sindikale paralajmëruese, gjegjësisht protesta me numër të kufizuar pjesëmarrësish dhe nëse edhe pas kësaj nuk do të ketë ndryshime pozitive, atëherë do të shkohet me veprime edhe më radikale, duke mos përjashtuar as grevën e përgjithshme në tërë sistemin arsimor që nga çerdhjet, në arsimin parauniversitar dhe në universitete", është thënë në reagimin e SBASHK-ut.

Lista "Guxo" regjistrohet si parti politike

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Lista "Guxo" është regjistruar si parti politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Përfaqësuesja e kësaj partie, Donika Gërvalla, ka thënë se lista "Guxo", e nisur nga presidentja Vjosa Osmani, të hënën i ka hyrë rrugës

institucionale. "Kam kënaqësinë e veçantë t'ju përshëndes sot nga kjo seli. Iniciativa qytetare lista 'Guxo', e nisur nga presidentja Vjosa Osmani, sot i ka hyrë rrugës institucionale. Kjo iniciativë ka sukses të jashtëzakonshëm. Platforma politike e 'Guxo', si parti me demokracinë e brendshme të zgjeruar", ka thënë Gërvalla, e cila në këtë qeveri mban pozitën e

ministres së Punëve të Jashtme. Ajo ka thënë se "Guxo" do të merret me një varg temash, me theks të veçantë arsimin dhe sistemin shëndetësor. Pjesë e kësaj partie është edhe ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Faton Peci. "Duhet të guxojmë dhe mundemi të guxojmë. Ne nuk vrapojmë, nuk bëjmë eksperimente duhet të bashkojmë

sa më shumë njerëz, e njëjta vlen edhe për tema të tjera, pra për sistemin shëndetësor si ta modernizojmë, e të mos përqendrohemi vetëm në Prishtinë, por në të gjitha rajonet e Kosovës", ka thënë Gërvalla. "Guxo" ende nuk i ka caktuar pozitë në parti e këtë, sipas Gërvallës, do ta bëjnë në Kuvendin Zgjedhor. "Vjosa Osmani është

themeluese e kësaj partie. Është e pazëvendësueshme për skenën e partisë e për listën 'Guxo'. Presidentja është zgjedhur me një votë masive për t'u bërë presidente. Ne me Lëvizjen Vetëvendosje jemi së bashku grup parlamentar. Unë kam marrë përsipër (drejtimin e partisë) deri në Kuvendin zgjedhur", ka thënë Gërvalla.

Bien rastet me të infektuar me Covid

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se prej 2 314 testimeve, 247 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar dy raste të vdekjes. Të hënën janë shënuar 2 096

qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 209 312. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 10 800. Në 24 orët e fundit janë dhënë 302 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në

të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 801 548 doza të vaksinës. Deri më sot 810 798 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 93 507 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Rusia "sheh" mundësi për marrëveshje me Perëndimin

MOSKË, 14 SHKURT - Ministri i Punëve të Jashtme i Rusisë, Sergei Lavrov, i ka sugjeruar të hënën presidentit rus Vladimir Putin që Moskë ta vazhdojë rrugën diplomatike në përpjekjet për të siguruar garanci të sigurisë nga Perëndimi, ndërkohë që rriten tensionet rreth Ukrainës. Lavrov i ka thënë Putin se Shtetet e Bashkuara kanë bërë propozime konkrete për zvogëlim të rreziqeve ushtarake, mirëpo ka thënë se nuk kanë qenë të kënaqshme përgjigjet nga Bashkimi Evropian dhe aleanca ushtarake e NATO-s. Në një komunikim televiziv, Putini është parë duke i kërkuar Lavrovit nëse ka mundësi të arrijës së marrëveshjes për t'i adresuar shqetësimet ruse për siguri, apo nëse palët janë vetëm duke hyrë në negociata të vështira.

Lavrov ka thënë se pala ruse tashmë ka paralajmëruar më shumë se një herë "që nuk do të lejohet negociata pa fund për pyetjet që kërkojnë zgjidhje sot". "Mirëpo si ministër i Jashtëm duhet të them se ka gjithmonë mundësi". Këto komente janë parë si shenjë për ulje të mundësisë së pushtimit rus, pas paralajmërimeve të vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara se Rusia mund ta sulmojë Ukrainën në çdo kohë. Moskë, e cila ka mbledhur më shumë se 100 000 trupa afër kufirit të Rusisë me Ukrainën, ka mohuar planet për pushtim dhe ka akuzuar ShBA-në dhe aleatët e saj për histeri. Lavrov ka thënë se ka pranuar përgjigje "jo të kënaqshme" pas një letre që u ka dërguar dhjetëra anëtarëve të BE-së dhe NATO-s sa i përket "sigurisë së

pandashme" - referencë ndaj ankesës së Rusisë se Ukraina dhe shtetet e Perëndimit janë duke rritur sigurinë në kurriz të Rusisë dhe se kjo përbën shkelje të marrëveshjeve ndërkombëtare. "Kam pranuar përgjigje jo të kënaqshme, asnjëri prej kolegëve ministra nuk i është përgjigjur drejtpërdrejt mesazhit", ka thënë ai. "Prandaj ne do të kërkojmë reagim konkret nga secili shtet". Në kërkesat e Moskës ndaj Perëndimit përfshihen edhe ato që: Ukraina të mos pranohet në NATO; NATO-ja t'i japë fund aktivitetit ushtarak në Evropën Lindore dhe t'i tërheqë trupat nga Polonia dhe republikat baltike, Estonia, Letonia dhe Lituania; si dhe Aleanca veriatlantike të mos pozicionojë raketa në shtetet afër apo në kufi me Rusinë.



Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja janë përgjigjur duke thënë se Ukraina ka të drejtë të zgjedhë aleatët e vet, mirëpo i kanë ofruar Rusisë mundësinë e negociimit rreth raketave dhe çështjeve të tjera. Nëse Rusia pushton Ukrainën,

kjo nuk do të ishte hera e parë. Rusia ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014. Ky vend, po ashtu, mbështet rebelët në konfliktet në rajonet lindore të Ukrainës, në të cilat kanë vdekur rreth 14 000 persona.

Pjesëtarët e grupit Lev Tahor gjenden në Kumanovë

KUMANOVË, 14 SHKURT - Një grup i pjesëtarëve të sektit fetar hebre, Lev Tahor, po qëndron në qytetin e Kumanovës në Maqedoninë e Veriut nga data 5 shkurt. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, bëhet fjalë për 30 persona të cilët në Maqedoninë e Veriut kanë hyrë përmes Aeroportit të Shkupit. Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar se "bëhet fjalë për një grup fetar hebre që është vazhdimisht në lëvizje pasi është detyruar të largohet nga shumë vende si Izraeli, Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe Meksika". Sipas policisë, grupi përfshin shtetas amerikanë, kanadezë, belgë dhe amerikanë-jugorë. Detaje mbi arsyet e largimit të

tyre nga këto vende nuk janë bërë me dije. "Njoftojmë opinionin se personat e vërejtur në Kumanovë janë një grup i pjesëtarëve të bashkësisë fetare hebre. Këta persona i respektojnë ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ata janë këtu në përputhje me dispozitat ligjore dhe kanë leje për qëndrim të përkohshëm në Maqedoninë e Veriut", është thënë në njoftimin e Policisë. Sipas ligjit maqedonas, personat që kanë lejeqëndrim të përkohshëm mund të qëndrojnë 90 ditë në këtë shtet. Sipas disa xhirimeve të publikuara në rrjete sociale, duket se ata janë strehuar në një shtëpi private, në pjesën



maqedonase të Kumanovës. Njoftimi i Policisë është bërë pasi në rrjetet sociale ka pasur reagime të shumta nga qytetarët mbi veshjen dhe

lëvizjet në grup të këtyre personave. "Grupi nuk paraqet ndonjë rrezik dhe apelojmë për tolerancë dhe solidaritet me të. Sipas të dhënave që kemi, grupi

është në lëvizje të vazhdueshme dhe pritet të largohet nga vendi ynë në ditë në vijim", ka bërë me dije policia në Kumanovë.

Suedia rekomandon dozën e katërt të vaksinës për të moshuarit

STOKHOLM, 14 SHKURT - Agjencia Shëndetësore e Suedisë ka rekomanduar që qytetarët 80 vjeç e më të vjetër ta marrin dozën e katërt të vaksinës kundër koronavirusit, me qëllim që të mos bie efektiviteti i vaksinave. Në rekomandimin e bërë të hënën nga kjo agjenci thuhet se doza e katërt rekomandohet për të gjithë personat që jetojnë në shtëpi të kujdesit apo ata që marrin shërbime asistencë në shtëpi.

Doza e katërt, sipas rekomandimit, duhet të administrohet të paktën katër muaj pas dozës përforcuese, ka njoftuar Agjencia Shëndetësore. Suedia më herët gjatë këtij viti shënoi shifra rekorde të infektiveve, teksa varianti Omicron i koronavirusit është përhapur me shpejtësi në mbarë shtetin. Por, autoritetet suedeze kanë hequr kufizimet, duke argumentuar se simptomat më të buta nga varianti Omicron

dhe fushata e imunizimit me doza përforcuese, kanë ulur presionin ndaj sistemit të kujdesit shëndetësor. "Doza përforcuese rrit mbrojtjen. Prandaj, ne besojmë se personat 80 vjeç e më të vjetër do të përfitojnë nga një dozë e dytë përforcuese", ka thënë epidemiologu Anders Tegnell. Agjencia Shëndetësore Suedeze ka njoftuar se dozat përforcuese duhet të jenë të kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "Moderna".



Rusi-Ukrainë / Jemi vërtet në prag të konfliktit? Ja përgjigjet



Eshtë momenti i vendimeve. Por kriza e Ukrainës është e mbushur me pasiguri të thella dhe shqetësuese. Në skenë janë dy protagonistë: Presidenti amerikan, Joe Biden dhe presidenti rus, Vladimir Putin.

Përse ndodhi ky përshkallëzim?

Në orët e fundit, qeveria amerikane është bindur se Putini është vërtet gati të sulmojë Ukrainën. Shtëpia e Bardhë mund të mbështetet në thelb në dy burime informacioni: pamjet satelitore dhe raportet e shërbimeve të fshehta në terren (CIA dhe shërbimi i fshehtë i ushtrisë). Pamjet janë konsideruar të pangatërrueshme: Moskë po vazhdon të grumbullojë jo vetëm ushtarë, por edhe raketa, avionë dhe helikopterë. Sipas Pentagonit, forcat ruse janë tashmë në gjendje të godasin në fronte të ndryshme. Këshilltari

për Sigurinë Kombëtare, Jake Sullivan dy ditë më parë ishte i qartë: nuk mund të përjashtohet bombardimi i Kievit.

Çfarë llogarish politike bën Putini?

Sipas amerikanëve, frenuesi i vetëm mund të jetë vetëm ekonomik. Shtëpia e Bardhë po bind ende aleatët evropianë që të godasin eksportet ruse të gazit, në rast pushtimi. Zyrtarisht, SHBA dhe BE thonë se janë në një linjë. Por shumëkush mendon që nuk është kështu. Mes këtyre janë sigurisht rusët. Prej këtu buron llogaria politike e Putinit: vende të ndryshme, si Gjermania dhe

Italia, nuk do të ishin të gatshme të përballonin një "black out" energjetik rus. Udhëheqësi i Kremlinit, mendon se mund ta mbajë të lartë tensionin, deri kur të mund të arrihet një marrëveshje për një lloj neutraliteti, ose "finlandizimi të Ukrainës". Ose do të zgjedhë "opsionin ushtarak", ndoshta me sulme të kufizuara, ose bllokime detare, duke shpresuar që të çarat e sotme në bllokun perëndimor të zgjerohen nesër, në momentin kur do të duhet të vendosen konkretisht sanksione. Eshtë një operacion shumë i rrezikshëm. Por jo pa logjikë, siç do të ishte pushtimi total i Ukrainës.

Dhe llogaritë e Bidenit?

Një gjë është e sigurt: presidenti amerikan nuk ka kërkuar përplasjen me rusët. Agjenda e tij ishte një tjetër. Biden është i bindur se kriza ukrainase është e mbushur me risqe edhe në

politikën e brendshme. Arsyja është shumë e thjeshtë. Nëse Putini bën bllof ose në fund mbërrihet në një marrëveshje, do të jenë shumë që do të marrin meritat. Por nëse udhëheqësi rus sulmon dhe paralizon gjysmën e Perëndimit, atëherë të gjithë do të nxjerrin në pah përgjegjësitë, "dobësinë" e Bidenit. Në fillim të vitit 2021 Administrata e SHBA mendonte se mund të "stabilizonte" marrëdhëniet me Kremlinin, duke ofruar bashkëpunim mbi terrorizmin dhe një plan gradual çarmatimi. Sot është e detyruar të përshtasë linjën politike, duke u përgatitur për një përplasje me Moskën si ato të viteve gjashtëdhjetë. Shtëpia e Bardhë nuk do që të gjendet e papërgatitur në asnjë nivel, kjo me koston që të shfaqet edhe alarmiste. Ja përse po u bën thirrje qytetarëve amerikanë që të largohen nga Kiev: nuk duhet të përsëriten skenat poshtëruese të panikut që u panë në Kabul vitin e kaluar.

Cili është roli i Kinës?

Këshilltarët e Bidenit përsërisin shpesh: "SHBA nuk kanë luksin që të përqëndrohen vetëm në një rajon të botës". Në Uashington konsiderojnë "kontigjent" aksin mes Putinit dhe Xi Jinpingut. Departamenti i Shtetit mendon se dy vendet kanë interesa ekonomike dhe strategjike shumë të ndryshme, për të farkëtuar një koalicion të vërtetë antiperëndimor. Megjithatë ka edhe sinjale që bien ndesh prej disa vitesh. Stërvitja e parë e përbashkët ushtarake mes Rusisë dhe Kinës ndodhi në 2017, në Detin Balltik. Në krizën ukrainase, Pekini po i rreh shpatullat Moskës. Në Uashington është e qartë tashmë se ndeshja është e dyfishtë. Zëvendës Sekretarja e Shtetit, Uendi Shelman e ka thënë në mënyrë eksplicite: nëse i hapim rrugë Putinit, praktikisht jemi duke dorëzuar Taivanin tek Xi Jinping.
/ Corriere della Sera – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-DORAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Liga e Kampionëve rikthehet me superpërballjen PSG - Real



"Epoka e re"

PARIS, 14 SHKURT - Liga e Kampionëve rikthehet pas një pauze të gjatë me ndeshjen derbi në mes të Paris Saint-Germainit dhe Real Madridit që përballen në kuadër të ndeshjes së parë të 1/16 e Ligës së Kampionëve. PSG-ja përfundoi e dyta në Grupin A, duke siguruar kalimin në fazën e eliminimit direkt, ndërsa trembëdhjetë herë fituesi i kësaj gare, Real Madridi, siguroi pozitën e parë në Grupin D. Skuadra franceze nënshkroi me Lionel Messin verën e kaluar me synimin që argentinasi ta ndihmojë t'i shkojë kësaj

gare deri në fund. Ndeshja kthyesë në "Bernabeu", ku edhe vendoset skuadra që shkon në çerekfinale, zhvillohet më 9 mars. PSG-ja, e cila u mund nga Real Madridi në këtë fazë të kompeticionit 2017-18, humbi nga Manchester City në gjysmëfinale të turneut të sezonit të kaluar, ndërsa arriti edhe në finale më 2019-2020. Gjigantët francezë nuk po arrijnë asesi të triumfojnë në garën më të fortë në futboll. Në anën tjetër, Reali, që është skuadra me e suksesshme e kësaj gare, synon që në këtë edicion ta fitojë trofeun e katërmbëdhjetë, por fillimisht duhet të tregojë se është në gjendje të eliminojë një skuadër të fuqishme siç është PSG-ja.

Lajm i mirë për trajnerin Pochettino është se për këtë ndeshje rikthehet ylli Neymar, ndërsa për shkak të lëndimeve do të mungojnë Sergio Ramos dhe Ander Herrera. Mungesë tjetër është edhe Idrissa Gueye, që ishte pjesë e Senegalit në Kupën e Kombeve të Afrikës. Në anën tjetër, Reali do të jetë pa Ferland Mendy, kurse Karim Benzema pritet të jetë i gatshëm për këtë ndeshje. Sonte (e martë) zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Sportingut dhe Manchester Cityt.

TË MARTËN TAKOHEN:
21:00 Paris Saint-Germain - Real Madrid
21:00 Sporting - Manchester City

SHKURT

Lum Namani, 'ylli i javës' në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova vazhdojnë ta ndajnë çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. Çmimin për xhiron e 19 e fitoi futbollisti në radhët e FC Drita, Hamdi Namani. Mesfushori qendror i bardhekaltërve realizoi tre gola në ndeshjen kundër KF Feronikeli, të cilën skuadra e tij e fitoi me rezultat bindës (7-0). Me këtë fitore Drita FC ka marrë kryesimin në renditjen e BKT Superligës, me 37 pikë. Çmimin "ylli i javës" për 27-vjeçarën e FC Drita e dha Alpay Mustafa, specialist në BKT.

Drejtuesit e KOK-it takohen me presidentin e Komitetit Olimpik të Belgjikës

Drejtuesit e KOK-it, presidenti Ismet Krasniqi dhe anëtari i Bordit Ekzekutiv, Jeton Beqiri, kanë zhvilluar takim me presidentin e Komitetit Olimpik të Belgjikës, Saive Jan Michel. Në takimin e mbajtur në Pekin të Kinës, ku po mbahen Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022", palët kanë biseduar çështje të ndryshme të bashkëpunimit mes dy Komiteteve Olimpikë. Presidenti Jan Michel vjen nga sporti i ping pongut, ku ka lënë gjurmë si pingpongist, sport ky prej nga vjen edhe anëtari i BE, Beqiri, i cili është edhe kryetar i Federatës së Pingpongut të Kosovës.

Uzuni: Ishim mirë deri te penalltia, Granada nuk dorëzohet

Myrto Uzuni ishte titullar sërish me Granadan në La Liga, këtë herë kundër Real Sociedadit. Skuadra e sulmuesit shqiptar u mund, ndërkohë që Uzuni, pas ndeshjes, ka deklaruar: "Deri te penalltia për Real Sociedadin luajtëm shumë mirë dhe kishim mundësi të shënonim gol. Nëse do të kishim shënuar, atëherë loja do të kishte shkuar ndryshe. Ky është futbollit. Mentaliteti ynë është që të mos dorëzohemi kurrë dhe të luftojmë deri në fund për këtë fanellë. Ekipi nuk dorëzohet kurrë. Ky është një klub fantastik, me një trajner të madh dhe ne gjithmonë punojmë së bashku. Duhet të vazhdojmë të luftojmë për t'i arritur qëllimet tona dhe për të fituar", ka shtuar Uzuni.

Bostoni dhe Minnesota korrin fitore me peshë për zonën 'play-off'

BOSTON, 14 SHKURT - Dy ndeshje janë luajtur në NBA. Ekipi i Boston Celticsit fitoi me rezultat 105-95 ndaj Atlantias, ndeshje e dominuar nga vendasit. Ndeshje mjaft e mirë për

Tatum, autor i 38 pikëve e 10 reboundeve për vendasit, duke i bërë të pavlefshme 30 pikët e Youngut e 26 të Bogdanoviqit për Hawksin. Falë këtij suksesi, Bostoni konsolidon pozitat në zonën

"play-off" në Lindje. Fiton edhe Minnesota, që e mposhti me rezultat 129-120 Indianan jashtë fushës. Ndeshje me rivalitet, ku për miqtë u dallua Edwardsi me 37 pikë, mbështetur edhe

nga Russell me 23 pikë. Për Indianan, Brissetti e Haliburtoni realizuan nga 22 pikë secili, por që mbetën për statistikë. Minnesota qëndron në vendin e shtatë në Perëndim.



Dushku dhe Hasani, pjesëmarrëse në shortin dhe "workshop"-in për kategoritë e reja

PRISHTINË, 14 SHKURT - Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Elvira Dushku dhe menaxherja e Eventeve dhe Basketbollit 3x3, Artina Hasani, do të marrin pjesë në shortin për kategoritë e reja, që do të mbahet më 15 shkurt (e martë) nga ora 11:00 në Freising të Gjermanisë. Ndërkohë, ditën e martë dhe të mërkurë do të mbahet Workshopi, për organizatorët e kampionateve evropiane për kategori të reja. Dushku dhe Hasani do të përcjellin nga afër shortin, si dhe do të njoftohen me rregullat për Evropianin në Prishtinë, duke marrë parasysh situatën me Covid-19 në mbarë botën. Kosova sërish do të jetë organizatore gjatë kësaj vere, pasi në tri herët e kaluara ka organizuar me sukses garat ndërkombëtare. Në Prishtinë, nga 12 deri më 17 korrik, do të zhvillohet Kampionati Evropian, Divizioni C për U16 në konkurrencën e meshkujve. Federata e Basketbollit të Kosovës ka marrë përgjegjësi për organizimin e Evropianit të Divizionit C, për U18 dhe U16 te meshkujt dhe Evropianit B për U20 për femrat. Kosova do të marrë pjesë me



femrat për Shtetet e Vogla në Qipro, me U20 te femrat, si dhe U20, U18 dhe U16 te meshkujt. Vitin e kaluar Kosova fitoi medaljen e artë për Challengersin U16 te meshkujt që u zhvillua në Prishtinë, për U18 te meshkujt që u zhvillua në Tiranë dhe medaljen e bronzitë për Kosovën A të femrave, në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla.

Kosova A femrat

Kampionati Evropian për Shtetet e Vogla në konkurrencën e femrave për Përfaqësuesen A do të mbahet në Nikozia të Qipros prej 28 qershorit deri më 3 korrik 2022.

Kosova U20 femrat

Kosova U20 te femrat do të marrë pjesë në FIBA European

Championship, Divizioni B, që mbahet në Shkup të Maqedonisë Veriore, nga 9 deri më 17 korrik 2022.

U16M

Në Prishtinë do të organizohet FIBA U16 European Championship, Divizioni C nga 12 deri më 17 korrik.

U18M

U18 te meshkujt do të marrë pjesë, po ashtu në FIBA European Championship, Divizioni B, që zhvillohet nga 29 korriku deri më 7 gusht në Oradea të Rumanisë.

U20M

U20 te meshkujt do të marrë pjesë në Tbilisi të Gjeorgjisë nga 15 deri më 24 korrik, në FIBA European Championship, Divizioni B.

Gati ekipet e 'All Star Game', Jamesi sfidon Durantin

CLEVELAND, 14 SHKURT - Më 18 shkurt në Cleveland do të luhet superndeshja "All Star Game": në basketbollin amerikan, në një duel të vetëm ku yjet e NBA-s dhurojnë spektakël. Pas zgjedhjes së kapitenëve të skuadrave, ku nga Konferenca e Perëndimit është lideri i Los Angeles Lakers, LeBron James, dhe nga Lindja, Kevin Durant, janë përzgjedhur lojtarët me të cilët do të luajnë përballë njëri-tjetrit në ndeshjen magjike të "All Star Game". James dhe Durant ishin dy më të votuarit nga tifozët dhe dy ekipet do t'i mbajnë emrat e tyre. Fatkeqësisht, ylli i Brooklyn Netsit, Durant, nuk do të luajë pasi është i lënduar. LeBron ka zgjedhur të parin dhe ka afruar në ekipin e tij Gianni



Antetokounmpo e Stephen Curry. Ajo që ra në sy ishte se Kevin Duranti nuk mori në ekipin e tij ish-shokun e skuadrës James Harden, që në limite u transferua te Philadelphia dhe kështu përfundoi te skuadra e James. Kjo situatë krijoi të qeshura dhe polemika.

Ekipi i LeBron James: Antetokounmpo, Curry, DeRozan, Jokiç, LeBron James. Në stol: Doncic, Garland, Paul, Butler, Mitchell, VanVleet dhe Harden.

Ekipi i Kevin Durant: Embiid, Morant, Tatum, Wiggins, Young. Në stol: Booker, Towns, LaVine, Murray, Middleton, Ball, Gobert.

Hakimi: Reali nuk kishte besim tek unë, por loja ime në fushë po i tregon të gjitha

Achraf Hakimi, në intervistë nga "MARCA", është një tjetër nga protagonistët e mëdhenj të duelit të nesërm në Paris. Hakimi ka qenë një lojtar në pronësi të "Los Blancos", ku më pas u huazua te Borussia

Dortmundi e pas gjermanëve tek Interi. Hakimi ka pasur gjithnjë të njëjtën formë te secili ekip që ka luajtur me një performancë të fortë dhe të shpejtë që e karakterizon. Ai është pyetur nga gazetari i

"Marca" për të dhe ish-ekipin e tij, Real Madrid. A ishte lamtumira e tij atëherë për shkak të mungesës së pjekurisë apo Real Madridit i mungonte besimi: "Pak nga të dyja. Është e vërtetë që kur i bashkohesh

Madridit për herë të parë, klubi nuk ka besim të plotë te ty sepse je i ri por, më pas, kur u largova në Dortmund, dola në huazim dhe pata dy sezone të shkëlqyera dhe më pas duhej të kthehesha dhe të vendosja për

të ardhmen time. Madridi ende nuk ishte i bindur për mua edhe pse pata dy sezone shumë të mira me Dortmundin. Ai nuk dëshironte të vendoste bast për mua".

SHKURT

Veteli: Nuk tërhiqem nga garat në fund të këtij sezoni

Piloti gjerman Sebastian Vettel, katër herë kampion bote në Formula 1, ka deklaruar se nuk do të tërhiqet nga sporti në fund të këtij sezoni. Ai garon me skuadrën Aston Martin, e cila pak ditë më parë ka bërë paraqitjen për mediet. "Së pari të shohim se në çfarë pike është makina e këtij sezoni. Më pas do të vendos për të ardhmen, por një gjë është e sigurt, që nuk do të tërhiqem nga garat në fund të këtij sezoni", u shpreh Vettel. "Kam fituar katër tituj në Formula 1 dhe është logjike që të ëndërroj e synoj të shpallej sërish kampion. Të shohim se si do të shkojnë provat zyrtare, madje mendoj se edhe gara e parë sezonale do të jetë një tip testi për ne", ka shtuar Vettel.

Spalletti: Interi, skuadra më e fortë në Serinë A

Trajneri i Napolit, Luciano Spalletti, është shprehur i kënaqur për barazimin në ndeshjen kundër Interit, duke e cilësuar skuadrën kampione si më të fortën në kampionat. "Kundër një skuadre si Interi është gjithmonë e vështurë. Provuam ta bënim lojën tonë dhe ndonjëherë e arritëm, ndonjëherë jo. Jemi rritur shumë dhe më intereson kjo, për më tepër që mendoj se kemi gabuar shumë pak. Duhet të jemi ambiciozë, por edhe me këmbë në tokë. Përballë kishim skuadrën më të fortë të Serisë A. Ata janë kampionët e Italisë, kanë shumë cilësi dhe forcën e tyre e kanë treguar në fushë dhe jo vetëm me fjalë", ka thënë Spalletti.

Chelsea dhe Barcelona garojnë De Ligtin

Chelsea dhe Barcelona janë futur në garë për futbollistin e Juventusit, Matthijs de Ligt. Lajmin e ka dhënë portali italian "Calciomercato". Qendërmbrojtësi holandez duket se është i interesuar për të lëvizur nga Torino gjatë verës që vjen. 22-vjeçarit do t'i skadojë kontrata me "Bianconeri" në vitin 2024. Por, Juve po e konsideron mundësinë e shitjes së lojtarit në fund të këtij sezoni. Në këtë drejtim po punon edhe menaxheri i ish-futbollistit të Ajaxit, Mino Raiola. Barcelona po planifikon t'i shpenzojë 75 milionë euro për De Ligtin, të cilin e sheh si pasardhës ideal të Gerard Piques, kurse Chelsea, po ashtu, po e përgatit një ofertë të majme për qendërmbrojtësin stabil. De Ligt mund ta zëvendësojë në Londër Antonio Rudigerin, i cili mund të largohet nga kampioni aktual evropian.

Conte: I pamundur vendi i katërt për Tottenhamin

Trajneri i Tottenham Hotspur, Antonio Conte, e ka pranuar se pothuajse është i pamundur që skuadra e tij të kualifikohet në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm, pas humbjes 2-0 të dielën kundër Wolves. "Kur i humb dy ndeshje në shtëpi dhe ndeshjen paraprake kundër Chelseat, një ekip që dëshiron të luftojë për Ligën e Kampionëve, është e pamundur. Problemi është se nuk mund ta blesh mentalitetin fitues. Atë e përçon nga dita në ditë dhe nuk je i sigurt që ndodh kështu sepse ka lojtarë të cilët janë më të hapur dhe e kuptojnë shpejt procesin dhe ka lojtarë të tjerë që kanë nevojë për më shumë kohë për ta kuptuar këtë", ka deklaruar Conte.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



14.02.2022
09/31

Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, të nenit 3, paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit për procedurat e përfuturimit nga programet e veçanta të banimit, dhe të nenit 4, paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr.23/2010, për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit-Komuna e Malishevës, në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kritereve për sigurimin e banimit familjar për **familjet me gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike**, me ndihmën e Programit të veçantë të banimit në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, jep banesa me qira joprofitabile për periudhën kohore të caktuar sipas marrëveshjes „Drejtoria e Shërbimeve Publike bënë shpalljen publike të:

KONKURSI

Komuna ka siguruar Program të veçantë banimit për **familjet me gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike**, që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, duke ndarë banesa me qira joprofitabile për të krijuar kushte të të përshatshme për banim normal.

Kanë të drejtë të jenë përfutur të këtij programi familjet që:

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
2. Kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë;
3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

Përcaktimi i personave/familjeve përfutur bëhet mbi bazën e kritereve të përparësisë si vijon:

- a. Statusi i banimit;
- b. Lartësia e të ardhurave;
- c. Gjendja shëndetësore;
- d. Invaliditeti i pjestarëve të familjes dhe
- e. Struktura familjare.

Kriteret shtesë janë:

- a. Familja e kryesuar nga një prind/prindi vetëushqyes dhe
- b. Familja që ka në mbikëqyrje/përkujdesje fëmijët jetim.

Familjet që bëjnë kërkesë për të përfutur nga ky program i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të komunës së Malishevës.

Për zgjedhjen e përfutur nga programi i veçantë i banimit, përparësi kanë familjet me numër më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të "Udhëzimit administrativ nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfutur nga programet e veçanta të banimit".

Në rast se aplikuesit pas vlerësimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve, atëherë përparësi do të kenë familjet me më shumë anëtarë" (sipas nenit 5, paragrafi 4, të Udhëzimit administrativ nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfutur nga programet e veçanta të banimit).

Komuna dhe MPMS si investitore, ka në dispozicion për këtë program të veçantë të banimit objektin banesore nr.02 të ndërtuar në Malishevë rruga "Hamdi Berisha", edhe me 6 (gjashtë) njësi/banesa, të cilat i jep me qira joprofitabile për kategoritë me gjendje të rëndë sociale ekonomike dhe të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

Organi komunal kompetent bënë shpërndarjen e aplikacioneve pa pagesë, në formë standarte, për të gjithë aplikuesit e interesuar, ndërkaq të gjithë aplikuesit të njëjtat mund të marrin në: **Zyrën për pritenjje dhe palëve në objektin e ri të KK-Malishevë, çdo ditë pune prej orës 8:00 h deri në orën 16:00 h.**

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Letër njoftimi i Republikës së Kosovës-kopje për aplikuesin dhe gjithë antarët e familjes mbi moshën 16 vjeçe;
2. Vërtetimin se familja nuk ka pasuri të paluajtshme, banesë/shtëpi në vendin /komunën e origjinës prej nga vjen aplikuesi;
3. Nëse aplikuesi/familja është me qira -Kontrata e qirasë, e vërtetuar nga noterit;
4. Certifikata e kadastrës për token/pasurinën e paluajtshme-e paraqitësit të kërkesës dhe antarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe /ose kujdestarëve;
5. Vërtetimin nga organi komunal i tatimit mbi prone, e paraqitësit të kërkesës dhe antarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe /ose kujdestarëve;
6. Vërtetimi se personi/familja është shfrytëzuese e ndihmës sociale-fotokopje kartela sociale me afate vlefshmërie;
7. Vërtetimi nga Ministria e Tregtisë dhe industrisë që aplikuesi apo ndonjëri nga antarët e familjes së tij nuk kryejnë aktivitet tregtarë (nuk kanë biznes);
8. Vërtetimi nga Departamenti i Punësimit (Enti i punësimit) për të gjithë antarët e familjes mbi 18 vjeç të cilët janë si kërkues pune, por që nuk janë të punësuar;
9. Vërtetimi punësimi nga punëdhënësi për çdo pjestarë të familjes i cili është i punësuar në Institucionet shtetërore apo Sektorin privat, ku cilësohet pozicioni i punës dhe paga e fituar (neto);
10. Vërtetimi nga organet kompetente i cili deklaron të ardhurat për personat të cilët janë në pension-Vendimi (origjinale);
11. Vendimet e pensioneve të personave me aftësi të kufizuar (PPAK) nga MPMS-ja për antarët e familjes, duhet të jenë me afatë të vlefshëm;
12. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës që (nuk punon) për aplikuesin dhe antarët e familjes që janë 18 vjeç e më tepër;
13. Dëshmia mbi gjendjen e llogarisë bankare për ekonomizim në Kosovë për 12 (dymbdhjetë) muajt e fundit për aplikuesin dhe antarëve të punuar në familje;
14. Familjet me sëmundje të rënda kronike dhe me probleme të përhershme shëndetësore-Të dhënat mbi këtë gjendje serioze shëndetësore të aplikuesit apo të antarëve të tjerë duhet të dokumentohen me vërtetim nga mjeku specialist ose komisioni i mjekësisë, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi;
15. Certifikata e mjekut për aftësinë e kufizuar-të aplikuesit ose e antarëve të tjerë të familjes, nëse parashtrus i kërkesës apo pjesëtari i tjetër i familjes paraqesin kërkesën në baza të aftësisë së përhershme të kufizuar;
16. Dëshmi apo vërtetim mbi përcaktimin e shkallës së invaliditetit-gjendje e vërtetuar sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi;
17. Certifikata apo deklarata e bashkësisë familjare;
18. Certifikata e lindjes-për të gjithë antarët e familjes;
19. Ekstrati i lindjes-vetëm për aplikuesin;
20. Vërtetim mbi vendbanimin e përhershëm;

21. Çdo aplikues duhet të jetë banorë i komunës së Malishevës së paku 5 (pesë) vjet para kohës së aplikimit-kjo vlen për personat e ardhur nga komunat tjera-të dëshmohet me dokumente relevante për këtë qëllim, p.sh. fletë shpërngullja nga komuna e ardhur;
22. Vërtetim nga shkolla-për fëmijët nga moshën 6-18 vjeç dhe 18-25 vjeç, të cilët janë në shkollim (universitet).
23. Certifikata e kurorëzimit-për personat e martuar në familje, posaçërisht për bashkëshortin/bashkëshorten e aplikuesit, nëse ai person është i përfshirë në kërkesën e paraqitur;
24. Certifikata e shkurorëzimit, në rastin e çifteve të divorcuara që kanë një apo më tepër fëmijë në mbikëqyrje/përkujdesje prindërore-të dëshmohet me vendim gjyqësor për mbikëqyrjen/përkujdesjen prindërore të fëmijës apo fëmijëve (origjinale ose i vërtetuar tek noterit);
25. Familja e cila ka në mbikëqyrje dhe përkujdesje fëmijë/fëmijët jetimë-dëshmohet kujdestaria me vendim nga autoriteti kompetent;
26. Të gjitha dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj nga dita e lëshimit të tyre;
27. Nëse ekziston arsyeja, do të kërkohen edhe dokumente të tjera shtesë;

- **Kërkesa e plotësura dhe dokumentacioni i nevojshëm dorëzohen dhe pranohen në Komunë në Zyrën për pritenjje dhe palëve në objektin e ri të KK-Malishevë çdo ditë pune.**
- Konkursi mbetet i hapur **30 (tridhjetë) ditë** nga dita e shpalljes publike në njërën nga gazetata e përditëshme, duke filluar prej dt: 14.02.2022 deri me dt: 14.03.2022, ndërsa raporti dhe dokumentacioni i kompletuar i përcillet komisionit vlerësues brenda 5 (pesë) ditësh.
- Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e familjeve bënë shqyrtimin e gjendjes së banimit dhe të dhënave të tjera të nevojshme të aplikuesve brenda **30 (tridhjetë) ditëve ndërkaq brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasuese do të bëjë vlerësimin dhe verifikimin në terren të parashtrusit të kërkesës.**
- Aplikacionet e dorëzura pas afatit kohor, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen të pavlefshme.
- Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për tu kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të banimit social.
- Ndalohet bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.
- Komuna në tabelën e shpalljeve do të publikojë listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
- Kohëzgjatja e përfuturimit nga programi i veçantë për banim është **3 (tre) vite**.
- Pas shpalljes së listës, familjet të renditura sipas pikëve të fituara dhe kundër Vendimit të Komisionit vlerësues, pala e pakënaqur mund të parashtrorë ankesë me shkrim brenda **30 (tridhjetë) ditëve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-MMPH**, nga dita e pranimit të Vendimit.

Për informata shtesë ju mund të paraqiti tek Drejtori i DSHP.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



NJOFTIMI I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyruar e Tatimit-ATK. Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar në "Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

Prema Zakonu br. 03 / L-222 Član 34, imovina opisana u nastavku oduzeta je zbog neplaćanja poreza, prinudnom naplatom poreza. Imovina će se prodati na aukciji zatvorenih ponuda kako je regulisano u „Zakonu 03 / L-222 o Poreska uprava i postupci “i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen: 25/02/2022

Vendi i shitjes: Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, Veternik prapa Albi Mallë ngjitur me Drganë „Rr. Hasan Hasanin Nr 40- Prishtinë.

Ponude će biti otvorene:

Mesto prodaje: Odeljenje za upravljanje naplatom dugova Veternik iza Albi Malle pored Carine, ul. Hasan Hasan Hasanin br. 40 - Prishtina .

Përshkrimi i Pasurisë /Opis imovine: Automjetet në shitje me (targa vendore)

- 1- FORDE FIESTA E KALTER METALIK AUTOMOBIL 2012 - WFOJXXGAIJCL83128
- 2- FORDE FIESTA E ZEZE METALIK AUTOMOBIL 2012 - WFOJXXGAIJCY24997
- 3- FORDE FIESTA KALTER METALIK AUTOMOBIL 2012- WFOJXXGAIJCL83133
- 4- DAIMIERN CHRYSLER 313 CDI MINIBUS BARDHE 2005-WDB9036631R874736
- 5- CITIEN AUTOAMBULANTA BARDHE 2009 - VFYAAMRA11378528
- 6- RENALUT Z AUTOMOBIL BARDHE 2011- VFILZBAO546210205

Kushtet e pjesëmarrjes: kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancia bankare) në shumën 10% të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurinë e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogarisë bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën. Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

Uslovi učešća: Uslovi učešća u licitaciji, kada se radi e nepokretnoj imovini, je avans (bankarska garancija) u iznosu od 10% neisplaćenih poreskih obaveza poreskog obveznika.

Dostavljanje ponuda: Sve ponude jasno identifikuju ponudjenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu, i broj bankarskog računa pojedina ili entiteta koji dostavlja ponudu treba da se primaju u zatvoreni pliko (koverat) pre gore specificiranog datuma i vremena .

Pasuria mund të inspektohet në Fushe Kosove përball Stacionit të Trenit në Depo e Mullir, çdo ditë pune prej orës 9:00 deri 15:00 nga data. 11/02/2022 deri më datën; 24/02/2022 dhe mund të kontaktoni personat zyrtar në tel mobil: 044/354/276 043/877/877 044/337/880

Imovina može da se pregleda u Kosovo Polje ispred Železničke Stanice Magacin Mlina svakim radnim danom od 9:00 do 15:00 od 10/2/2022 do; 24/02/2022 a službenike možete kontaktirati na mobilni telefon: 044/354/276 043/877/877 044/337/880

Administrata Tatimore e Kosovës/ Poreska uprava Kosova

Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve-Prishtinë
Odeljenje za Upravljanje Naplate Duga-Prishtina

Data/ Datum : 10.02.2022



Sot u bënë dy vjet pa më të dashurën tonë



Shefkije Preniqi Misini

(15.03.1945-15.02.2020)

Të rënda qenkan ditët kur mungon prania jote. Në këtë përvjetor qenka shumë vështirë të shkruajmë për ty, por megjithatë jemi krenare që patëm një nënë, gjyshe, motër, vjehërr siç ishe ti. Dashuria, mirësia dhe urtësia që kishe ndaj familjes dhe farefisit, na bën që mos të harrojmë kurrë.

Të jetosh në zemrat e atyre që lë pas, do të thotë të mos vdesësh kurrë.

Gjithmonë krenarë që të patëm dhe shumë të pikëlluar që të humbëm.

Edhe pse nuk je më fizikisht me ne, në zemrat tona do të jetosh gjithmonë.

Të kujtojnë me shumë mall: djemtë, vajzat, motra, rejat, nipat dhe mbesat.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumescdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Hamez Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Hamez Cena " Damjan Gjakovë.

Krenar Mustafa shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

Perparim Thaqi shpall të pavlefshme dëftesat , certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Festlind Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.

Agim Shaqiri shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Agjensioni Patundshmëri Privat Kosovar Peja me pronar Shaban Mujaj B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810406430.

Matis Morina i lindur me 29.01.2018 në Prishtinë, me nr. personal: 1251370075 shpall te pavlefshme Pasaportën e Republikës së Kosovës.

Qendrim Bejtullahu shpalle të pavlefshme dëftesën e vitit te II të shmlm Dr. "Xheladin Deda"

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

